



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2020:066886

Datë: 21.02.2025

Numri i dokumentit: 06879917

C.nr.760/20

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Agron Karatash, me bashkëpunëtorin profesional A.K. në çështjen juridike kontestimore të paditësve K.S. dhe I.G. që të dy nga Prizreni, të cilët me autorizim i përfaqëson av. V.H. nga Prishtina, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “Scardian” me seli në Prishtinë, me objekt kontesti kompensim dëmi material dhe jomaterial, vlera e kontestit 900.00 euro, jashtë seancës, me datë 21.02.2025, mori këtë:

A K T G J Y K I M **NË BAZË TË HEQJES DORË NGA KËRKESËPADIA**

REFUZOHET kërkesëpadia e paditësve K.S. dhe I.G. që të dy nga Prizreni, me të cilën kanë kërkuar që të *“OBLIGOHET e paditura Kompania e Sigurimeve “Scardian” me seli në Prishtinë, që paditësit veç e veç për secilin t’i kompensoj në emër të dëmit material dhe jomaterial, obligohet e paditura që në emër të zhdëmtimit të kompensoj dëmin e veturës sipas shumës së përcaktuar pas kryerjes së ekspertizës, si dhe Obligohet e paditura që për kompensimin e dëmit në formën dhe lartësinë e cekur t’i kompensoj nga data e ushtrimit të padisë, me kamatë ligjore, e gjerë në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës gjyqësore sa do të jenë sipas llogarisë, të gjitha në afat prej 15 ditëve nga dita kur aktgjykimi merr formën e prerë, nën kërcënimin e ekzekutimit të detyrueshëm”* **SI E PA BAZUAR.**

A r s y e t i m

Paditësit K.S. dhe I.G. që të dy nga Prizreni, përmes të autorizuarit të tyre av. V.H. nga Prishtina, pranë kësaj gjykate me datë 11.06.2020, kanë parashtruar padi kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “Scardian” me seli në Prishtinë, me objekt kontesti kompensim dëmi material, vlera e kontestit 900.00 euro.

Në referatin e padisë ka theksuar se me datën 30.04.2020, në ora 11:30, në Rr. “.....” në Prizren, ka ndodhur aksidenti i komunikacionit i regjistruar me nr. 2020-GR-0170, ku deri tek aksidenti kishte ardhur derisa vozitësi i automjetit A, i cili ishte duke lëvizur në rrugën në drejtim të rrugës dhe si pasojë e mospërshtatjes së shpejtësisë me pjesën frontale të automjetit e godet në pjesën e pasme veturën B e cila ka qenë në lëvizje para automjetit A, si rezultat i aksidentit përveç dëmeve materiale vozitësi i automjetit B dhe pasagjeri i cili gjendej në automjetin B janë dërguar në spitalin e Prizrenit.

Më tej ka theksuar nga automjeti me të cilën është shkaktuar aksidenti ka qenë i siguar tek K.S. “Scardian”. Polica e sigurimit mbanë këtë nr. 0007140177, me datë të skadimit 08.08.2019. Andaj duke qenë se i siguruari është fajtor për shkaktimin e aksidentit të datës 30.04.2020, nga baza e autopërgjegjësisë ndaj palës së tretë, e njëjta është e obliguar në kompensimin e dëmit, mbi bazën e lartcekurave i ka propozuar gjykatës që të aprovohet kërkesëpadia e paditësit në tërësi si e bazuar.

E paditura Kompania e Sigurimeve “Scardian” me përgjigjen në padi të cilën gjykatës ia ka dorëzuar me datë 24.10.2024, ka theksuar se me të autorizuarin e paditësve kanë arritur marrëveshje jashtëgjyqësore me të cilën marrëveshje e paditura në tërësi i ka përmbushur të gjitha obligimet, ku si provë i ka bashkangjitur marrëveshjen jashtëgjyqësore të datës 30.11.2020.

Ndërkohë i autorizuari i paditësve av. V.H. me e-mailin të cilën e ka dërguar në gjykatë me datë 20.02.2025, ka theksuar se meqenëse tashmë paditësi e ka realizuar kërkesën e tij, me këtë email ju njoftojmë se nuk kemi interes juridik që të vazhdojmë tutje dhe se tërhiqemi nga kërkesëpadia.

Gjykata, pas heqjes dorë nga kërkesëpadia nga ana e paditësve, konstatoi se kërkesat janë të disponueshme për palët, prandaj, në kuptim të nenit 3 par. 2 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK-së) ku përcaktohet se *“Palët mund të heqin dorë nga kërkesat e tyre, ta njohin kërkesën e palës kundërshtare si dhe të bëjnë ujdi (pajtim) gjyqësorë lidhur me kontestin e tyre”*, si dhe sipas nenit 149, par. 1 të LPK-së me të cilin përcaktohet se *“në qoftë se paditësi deri në përfundimin e seancës për shqyrtim kryesor të çështjes heqë dorë nga një pjesë e kërkesëpadiës apo nga e gjithë kërkesëpadia, gjykata pa shqyrtim të mëtejshëm e jep aktgjykimin me të cilin e refuzon kërkesëpadinë në pjesën nga e cila paditësi ka hequr dorë apo në tërësi (aktgjykimi në bazë të heqjes dorë)”*, andaj pa shqyrtim të mëtejshëm vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata në kuptim të dispozitave nga neni 3 par.3.2 dhe neni 149 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRIZREN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
2020:066886, 21.02.2025

B.profesional

Ali Kosova

Gjyqtari

Agron Karatash

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e pranimit, pranë Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate. Në kuptim të nenit 181, paragrafit 2 të LPK-së, ankesa mund të paraqitet vetëm për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore apo nga shkak se heqja dorë nga kërkesëpadia është dhënë në lajthitje apo nën ndikimin e dhunës apo mashtrimit.